



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

2007

PLANI I INTEGRUAR I MINISTRISË



# Mesazhi i Ministrit

Edhe gjatë vitit 2007 Ministria e Punëve të Jashtme, në zbatim të programit të Qeverisë për marrëdhëniet me jashtë, do të jetë tërësisht e angazhuar në përmbushjen e përgjegjësisë të saj në shërbim të integritit të vendit në strukturat euro-atlantike, së pari duke mbështetur por edhe duke tërhequr vëmendjen për të angazhuar maksimalisht institucionet e tjera shqiptare në plotësimin e standardeve integruese. Thelbi i punës së Ministrisë do të jetë angazhimi i strukturave të saj dhe i të gjitha energjive për të ndikuar tek vendet anëtare të BE-së për të siguruar ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit në një periudhë kohore sa më të shpejtë, çka do t'i hapë rrugën aplikimit për të përfituar statusin e vendit kandidat në BE.

Ora e së vërtetës historike për Kosovën e pavarur po afrohet. I gjithë komuniteti ndërkombëtar është i ndërgjegjshëm dhe i angazhuar për domosdoshmërinë e një zgjidhjeje të shpejtë, të qëndrueshme e që rregullon në mënyrë përfundimtare, mbi bazën e modelit të shoqërisë së hapur e demokratike, çështjen e fundit shtetformuese në Ballkan. Duke qenë prioriteti parësor afatshkurtër, Ministria do t'i ushtrojë maksimalisht përgjegjësitë e saj dhe do të ndjekë pa ndërprerje problematikën e qëndrimeve ndërkombëtare për këtë çështje në mënyrë që të jetë e përgatitur për çdo eventualitet. Avancimi i marrëdhënieve dypalëshe e shumëpalëshe diplomatike, ekonomike, politike e kulturore me të gjitha vendet e rajonit do të vazhdojë të ketë të njëjtin kujdes si një kontribut konkret në forcimin e paqes dhe stabilitetit në rajon.

Në vijim të përfundimeve të Samitit të Rigë-s, viti 2007 përbën një moment kyç në finalizimin e përpjekjeve tona shumëvjeçare për të marrë ftesën për tu pranuar në Aleancën e Atlantikut të Veriut. Asnjë përpjekje nuk do të kursehet për ta bërë këtë vit një moment shkëmbimi intensiv me sekretariatit e Aleancës dhe vendet anëtare, në përputhje me angazhimet tona në kuadër të Planit të Veprimit për anëtarësi.

MPJ do të vijojë ta vërë diplomacinë në shërbim të ekonomisë, burimeve dhe potencialeve të vendit, duke synuar tërheqjen e investimeve të huaja, paraqitjen reale dhe të përditësuar të mundësive ekonomike dhe turistike që ofron Shqipëria, duke bërë njëkohësisht të njohura vlerat kulturore që ofron vendi. Duke siguruar një prani më të mirë të vendit në organizatat ndërkombëtare, në nismat shumëpalëshe dhe aksionin ndërkombëtar në tërësi, Ministria e Punëve të Jashtme kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e rolit të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, mundëson prezantimin me të mirë e më të gjerë të vendit dhe imazhit të tij në botë.

Në një botë gjithnjë e më të ndërvarura e që po përballet me sfida të reja, kontributi i çdo vendi, pavarësisht nga madhësia, përbën një vlerë të shtuar në përpjekjet e përbashkëta për stabilitet, paqe, siguri dhe mirëqenie në botë. Ministria e Punëve të Jashtme do të vazhdojë ti përmbahet këtij synimi.

Lulëzim Basha

Ministër i Punëve të Jashtme

## Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë.....	2
2	Dokumenta strategjike të Ministrisë .....	3
3	Programet buxhetore të Ministrisë .....	6
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2007.....	7
5	Plani i Monitorimit të Ministrisë .....	10
Aneks 1	Projekt-ligjet për tu paraqitur .....	11
Aneks 2	Rezultate që lidhën me Programin e Qeverisë .....	13
Aneks 3	Rezultate që lidhën me integrimin Europian .....	14
Aneks 4	Rezultate që lidhën me anëtarisimin në NATO .....	15
Aneks 5	Investimet publike .....	16

# 1 Misioni i Ministrisë

Ministria e Punëve të Jashtme formulon, përpunon dhe është zbatuesi kryesor i politikës së jashtme të shtetit shqiptar, në zbatim të programit të qeverisë. MPJ në dialog dhe marrëdhënie me të gjithë partnerët ndërkombëtarë, pasqyron të gjitha zhvillimet në Shqipëri, përfaqëson e mbrojnë interesat kombëtare, si dhe punon për interesat e shtetasve shqiptarë kudo që ata ndodhen, në të mirë të lirisë, sigurisë dhe mirëqenies së tyre. Shërbimi i jashtëm i Republikës së Shqipërisë synon rritjen e rolit të Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare dhe ato rajonale, si dhe anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në aktet ndërkombëtare.

Ministria e Punëve të Jashtme, në zbatim të programit të Qeverisë për marrëdhëniet me jashtë, ka për mision parësor realizimin e prioriteteve në fushën e marrëdhënieve me jashtë, që në esencë synojnë:

- integritit të vendit në strukturat euro-atlantike,
- zgjidhjen përfundimtare dhe paqësore të statusit të Kosovës në kuadër të forcimit të bashkëpunimit dy e shumëpalësh rajonal,
- zgjerimin dhe forcimin e pranisë diplomatike të vendit, ngritje në një nivel më të lartë të marrëdhënieve midis shteteve si bazë për zhvillimet në fusha të ndryshme me interes të përbashkët dhe interes të përgjithshëm;
- vënien e diplomacisë në shërbim të ekonomisë dhe burimeve të vendit tonë duke synuar investime të huaja brenda vendit dhe reklamim më të madh të mundësive ekonomike, dhe turistike që ofron Shqipëria si dhe duke bërë të njohur vlerat kulturore që ofron vendi ynë.
- mbështetja e zhvillimeve të drejta rajonale që kanë për qëllim sigurinë, paqen dhe qetësinë në rajon dhe mbrojtjen e interesave kombëtare të vendit duke avancuar marrëdhëniet diplomatike, ekonomike, politike e kulturore me të gjitha vendet e rajonit.
- mbrojtjen e të drejtave të shtetasve të saj jashtë vendit.
- rritjen e rolit të Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare, nismat shumëpalëshe dhe koalicionet ndërkombëtare duke synuar avancimin e rolit të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, ngritjen e imazhit të vendit tonë në botë, përfshirjen në projekte shumëpalëshe që kanë për qëllim stabilitetin, paqen, sigurinë dhe mirëqenien në botë.

## 2 Dokumenta strategjike të Ministrisë

### Strategjia sektoriale e puneve të jashtme

Politika e jashtme e Republikës së Shqipërisë është në shërbim të prioriteteve të përmendura më lart si pjesë e misionit të saj.

#### Qëllime

Politika e këtij sektori është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

#### Bashkimi Evropian

Fokusi institucional mbetet ruajtja e vazhdimësisë dhe e ripërtëritjes së dialogut politik Shqipëri-BE, i cili është ngritur tashmë në një nivel më të lartë, me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit në qershor 2006. Duke e konsideruar këtë Marrëveshje si udhëzuesin bazë të reformave dhe hapave që duhet të ndërmerret shteti dhe e gjithë shoqëria, diplomacia shqiptare do të bëjë lobing pranë të gjitha kancelarive dhe qarqeve politike e diplomatike evropiane për ratifikimin e kësaj “Makrokontrate” nga të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian (27) brenda harkut kohor 2006-2009.

Duke qenë të ndërgjegjshëm për vetë zhvillimet horizontale në Bashkimin Evropian, Shqipëria do të përqendrohet për fitimin e statusit të vendit kandidat brenda vitit 2010, për t’u përqendruar më tej në përmbushjen e kushteve të reja që do të përfshijnë Shqipërinë në valën e re të zgjerimit të Unionit. Gjithashtu, duke marrë parasysh rolin që vendi ynë ka në raport me vendet e rajonit, dhe në mënyrë të spikatur në kontekstin e rolit të faktorit shqiptar në rajon, Ministria e Punëve të Jashtme do të përpiqet të ruajë vëmendjen e Bashkimit Evropian ndaj zhvillimeve rajonale dhe ndaj Shqipërisë gjatë gjithë aktivitetit të saj për vitin 2007.

Përshtatja e legjislacionit shqiptar me atë evropian, ndjekja e zbatimit të Marrëveshjes Interim si dhe përmbushja e të gjitha kriterëve të Kopenhagenit, do të jenë objekt i punës i Ministrisë së Punëve të Jashtme. Kjo veprimtari do të përqendrohet jo vetëm në kuadrin e marrëdhënieve me jashtë por edhe në rrafshin e brendshëm, për t’i bërë institucionet vendore dhe shoqërinë shqiptare gjithnjë e më të ndërgjegjshme rreth detyrimeve dhe privilegjeve që ofron procesi i integritimit evropian.

Ministria e Punëve të Jashtme do të vijojë procedurat për lehtësim deri në liberalizim të plotë të regjimit të vizave me Bashkimin Evropian, duke kaluar në faza përmblylëse të lehtësimit në 2007, dhe liberalizim 2012. Po kështu, pas njohjes me instrumentin e ri financiar të paraaderimit, do të riformulohet dhe përsëritet në mënyrë intensive kërkesa për riorganizimin e alokimit të fondeve ndaj Ballkanit Perëndimor, e në veçanti ndaj vendit tonë.

#### NATO

Diplomacia shqiptare është në fazën intensive dhe vendimtare dhe, së bashku me partnerët e A3, do të prezantojë dhe llojë në strukturat vendim marrëse të Aleancës progresin e bërë në të gjitha fushat, veçanërisht në ato fusha ku NATO është më sensitive.

Gjatë vitit 2007 do të vijojë puna për rritjen e kapaciteteve administrative, rritjen e kapaciteteve profesionale-diplomatike si dhe të prezencës dhe organizimit të aktiviteteve të nivelit të lartë, të shoqëruar me lobing për anëtarësimin e suksesshëm në NATO në vitin 2009.

## **Bashkëpunimi rajonal**

Ministria e Punëve të Jashtme do të mbështesë zhvillimet të drejta rajonale që kanë për qëllim sigurinë e paqes në rajon dhe mbrojtjen e interesave kombëtare të vendit, duke punuar për rritjen e rolit të Shqipërisë dhe duke synuar forcimin e bashkëpunimit, si dhe avancimin e marrëdhënieve diplomatike, ekonomike, politike e kulturore në funksion edhe të zbatimit të Marrëveshjes së Ohrit. Pozicionimi i Shqipërisë si faktor sigurie në Ballkan për forcimin e mëtejshëm të paqes dhe stabilitetit në rajon duke zgjeruar dhe intensifikuar marrëdhëniet diplomatike

Në qendër të vëmendjes së diplomacisë shqiptare për vitin 2007 do të jetë: forcimi dhe konsolidimi i marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit në të gjitha fushat me interes të ndërsjellë me vendet e rajonit tonë. Zgjerimi, intensifikimi i marrëdhënieve të gjithanshme, diplomatike, ekonomike, politike e kulturore mbi bazën e shtyllave kryesore të politikës së jashtme të Shqipërisë do të vlerësohet si i tillë, në shërbim të forcimit të paqes, stabilitetit, prosperitetit dhe integritetit evropian të të gjithë rajonit.

Në perspektivën e një rajoni të integruar në BE dhe NATO, do të synohet që përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm të hiqen barrierat që pengojnë komunikimin, lëvizjen e lirë të njerëzve, të mallrave, etj., duke krijuar një situatë sa më të qëndrueshme për të sjellë pashmangshmërisht një ndikim pozitiv tek partnerët ndërkombëtarë për një imazh të tjetërsuar e të ripërtërirë të rajonit tonë.

Realizimit të suksesshëm të këtyre synimeve do t'u përgjigjet një organizim më i mirë i veprimtarive të shumta me karakter shumëdimensional, intensifikim i dukshëm i kontakteve dy dhe shumëpalëshe. Në këtë kuadër, do të marrë përparësi institucionalizimi i dialogut politik në nivelet më të larta, forcimi i bashkëpunimit ekonomik, progresi i dukshëm i këtij bashkëpunimi në fusha si ajo e arsimit, shkencës, kulturës, turizmit, rendit, etj.

Këtij qëllimi do t'i shërbejë edhe hapja dhe funksionimi i Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Mal të Zi.

## **Kosova**

Politika e jashtme i përmbahet dhe më tej qëndrimit të njohur, se e vetmja rrugë për të siguruar paqe, siguri, bashkëpunim dhe harmoni të qëndrueshme në rajon dhe më gjerë, është njohja e vullnetit të lirë të popullit të Kosovës, pavarësia, e cila tashmë është një realitet. Gjatë viteve të ardhshme, përmes një veprimtarie konkrete bashkëpunimi të ngushtë, periudha post-status do të kërkonte zgjidhjen e shumë problemeve në Kosovë, ndërtimin e një shoqërie me të vërtetë të lirë dhe demokratike, përfshirjen dhe rolin e saj aktiv në proceset integruese rajonale dhe ato euroatlantike. Në këtë kuadër, do të zgjerohen kontaktet në të gjitha nivelet.

## **Organizatrat ndërkombëtare**

Politika e jashtme e Shqipërisë do të vazhdojë me intensitet të lartë pjesëmarrjen aktive, me të drejta të plota në shumë organizata ndërkombëtare e koalicione, ku më kryesoret janë OKB, Këshilli i Evropës, OSBE, Koalicioni Antiterror, UNESCO, Organizata e Frankofonisë si dhe dhjetëra e dhjetëra organizata, konventa, nisma, struktura ndërqeveritare e joqeveritare, me karakter ekonomik, kulturor, ekologjik, shkencor, juridik, arsimor etj;

## **Marrëdhëniet dypalëshe**

Politika e jashtme e Shqipërisë do të bazohet edhe në marrëdhëniet e mira e shume të mira dypalëshe, me vendet anëtare të Bashkimit Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me të gjitha vendet e botës demokratike apo të tjera me të cilat ndajmë interesa të përbashkëta. Kjo

do të jetë edhe bazë e sigurt për të ecur përpara në zgjerimin dhe intensifikimin e marrëdhënieve me secilin nga këto vende. Politika e jashtme e vendit do të mbështesë të gjitha potencialet që ofrojnë marrëdhëniet ndërkombëtare për të zhvilluar një diplomaci kulturore aktive, që do t'i shërbejë afirmimit të identitetit tonë kombëtar te popujt e tjerë si dhe shpalosjes së vërtetë të atyre vlerave për të cilat ka nevojë sot më shumë se kurrë imazhi i vendit tonë. Diplomacia kulturore, do të jetë një rrugë e veçantë për tërheqjen e turistëve si dhe për përfshirjen sa më gjerësisht dhe denjësisht të vendit tonë në procesin global të qarkullimit të vlerave kulturore në botën e sotme.

## **3 Programet buxhetore të Ministrisë**

### **3.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI**

Politika e këtij Programi konsiston ne mbështetjen e objektivave dhe strategjisë së Ministrisë së Punëve të Jashtme në përputhje me programin e Qeverisë, duke synuar integrimin e Shqipërisë në BE dhe në NATO; forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit rajonal dhe me organizatat ndërkombëtare ku Shqipëria tashmë është palë, me qëllim ruajtjen e interesave të Shqipërisë në favor të lirisë, sigurisë dhe mirëqenies së shqiptarëve në arenën ndërkombëtare.

### **3.2 PERFAQESITE DIPLOMATIKE DHE SHERBIMI KONSULLOR**

Politika e këtij Programi është përmirësimi i përfaqësive shqiptare në botë, rritja e profesionalizmit, e cilësisë së shërbimeve, e aftësive për të përfaqësuar dhe mbrojtur sa me denjësisht interesat e shtetit Shqiptar dhe shtetasve të tij në një kontekst ndërkombëtar shumë më aktiv, ndërveprues dhe gjithnjë e më kompleks.

## 4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2007

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme në 2007. Këto produkte përbëjnë Planin e Monitorimit të Ministrisë.

### 4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivat e politikës

- Integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe krijimi i kapaciteteve të nevojshme për përmbushjen e obligimeve të anëtarësimit
- Marrja e ftesës për anëtarësim në NATO deri në fund të vitit 2008 dhe përmbushja e obligimeve të anëtarësimit
- Forcimi dhe thellimi i mëtejshëm i marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe
- Zhvillimi i diplomacisë aktive ekonomike dhe kulturore në shërbim të tërheqjes së investimeve të huaja, afirmimit të identitetit kombëtar dhe përmirësimit të imazhit të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare
- Menaxhimi dhe administrimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme në kuadër të përmirësimit të kushteve të punës
- Mbrojtja e vazhdueshme e të drejtave dhe interesave të shtetasve tanë jashtë vendit nëpërmjet një shërbimi publik cilësor

Produktet që do të ofrohen

- Fillimi i negociatave për lehtësimin e rrëgjimit të vizave dhe përfundimi i marrëveshjes brenda vitit 2007
- Nënshkrimi i Marrëveshjes për Lehtësimin e Regjimit të Vizave mes BE-së dhe Shqipërisë para fundit të vitit dhe vazhdimi i përpjekjeve të mëtejshme deri në liberalizimin e regjimit të vizave me BE-në
- Zhvillimi dhe thellimi i mëtejshëm i dialogut politik me BE-në nëpërmjet organizimit, monitorimit dhe kontrollit të burimeve njerëzore dhe financiare dhe shtimit të aktivitetit diplomatik të institucionit
- Sigurimi i lobimit nëpërmjet zhvillimit të vizitave, takimeve dhe aktiviteteve të ndryshme me objekt kërkesën për anëtarësim të Shqipërisë në NATO
- Zbatimi i prioriteteve dhe përkushtimi i vëmendjes maksimale ndaj detyrimeve dhe zbatimi i angazhimeve të marra në kuadër të NATO-s, në veçanti në zbatim të Planit të Veprimit për Anëtarësi (MAP)
- Sigurimi nëpërmjet përfaqësimit, i një pjesëmarrje aktive dhe angazhim të qenësishëm në të gjitha organizatat, nismat apo konferencat ndërkombëtare dhe rajonale në të cilat merr pjesë apo aspiron shteti ynë
- Mbrojtja e interesave kombëtare dhe e sigurimit të një shteti të pavarur të ligjit dhe të së drejtës në Kosovë
- Pjesëmarrje aktive në takimet e rëndësishme të Organizatave ndërkombëtare apo forumeve të tjera shumëpalëshe (Mbledhjet ministrore në kuadër të OSBE-së, KE-së, OKB-së etj.)
- Përmbushja e detyrimeve vjetore financiare ndaj Organizatave të ndryshme Ndërkombëtare
- Përgatitja dhe përfundimi i raporteve (2 raporte) nga pala shqiptare, në kuadër të Konventave për të Drejtat e Njeriut dhe të Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM)

- Realizimi i vizitave dypalëshe të titullarëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme në vende të ndryshme, në kuadër të përmirësimit dhe të forcimit të mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe
- Zhvillimi i takimeve të Ministrisë së Punëve të Jashtme me ambasadorët e RSH-se të akredituar jashtë vendit në formën e konsultimeve tematike
- Realizimi i marrjes së kryesisë së radhës së OSBE-se për vitin 2012, pas paraqitjes së kërkesës nga shteti shqiptar
- Thëllimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit ekonomik nëpërmjet paraqitjes dhe nënshkrimit të Protokolleve të Bashkëpunimit Ekonomik
- Përmirësimi i imazhit të Shqipërisë dhe shqiptarëve në arenën ndërkombëtare
- Realizimi i reformës së përgjithshme administrative të Ministrisë së Punëve të Jashtme
- Realizimi i trajnimeve të vazhdueshme të stafit të MPJ-së për burimet njerëzore, me qëllim përgatitjen e tyre profesionale
- Hartimi dhe zbatimi i një programi të veçantë me synim nxitjen për ratifikimin e shpejtë të MSA-së nga Parlamentet e vendeve anëtare të BE-se

## 4.2 PERFAQESITE DIPLOMATIKE DHE SHËRBIMI KONSULLOR

### Objektivat e politikës

- Reforme e gjere ne rrjetin e përfaqësive shqiptare me qëllim përmirësimin e cilësisë së përfaqësimit dhe zgjerimin e pranisë sonë diplomatike
- Fuqizimi i përfaqësive shqiptare në bote me qëllim përmirësimin e imazhit të Shqipërisë dhe institucionalizimin e mëtejshëm të marrëdhënieve bilaterale
- Përfaqësimi dhe përmirësimi i shërbimeve ndaj shtetasve shqiptarë dhe diasporës
- Ngritja e nivelit profesional të diplomateve shqiptarë nëpërmjet realizimit të trajnimeve të ndryshme

### Produktet që do të ofrohen

- Hapja e përfaqësisë shqiptare në Mal të Zi
- Me fitimin e pavarësisë, zyra e në Kosovë do të ngrihet në rangun e Ambasadës
- Hapja e Konsullatës në Nju Jork
- Kalimi i disa prej përfaqësive shqiptare në bote nga përfaqësi të kategorisë së dytë në përfaqësi të kategorisë së parë
- Shtimi i personelit të disa përfaqësive me qëllim përmirësimin e punës dhe ngritjen e nivelit të saj në Bruksel, Podgoricë, Londër, Gjenevë, Nju Jork
- Eksplorimi i mundësisë për blerjen nga shteti shqiptar i godinave të ambasadave në një prej vendeve perëndimore (Berlin ose Paris) si dhe rikonstruksioni i disa prej godinave ekzistuese
- Organizimi i vazhdueshëm i takimeve nga diplomatet shqiptarë me qëllim përmirësimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe
- Përmirësimi i shërbimeve konsullore nëpërmjet përmirësimit të normave ligjore, krijimit të sistemit të rrjetëzuar të informacionit, shfrytëzimit të shërbimit postar në sektorin konsullor, rritjen e transparencës, trajnimit të punonjësve konsullorë dhe hartimit të manualeve konsullore (rreth 17 prej tyre)
- Përmirësimi i cilësisë së informacionit dhe i vizibilitetit të aktivitetit diplomatik duke krijuar faqet Internet të veçanta për çdo përfaqësi diplomatike

Tabela Buxheti 2007 sipas programeve dhe llojeve te shpenzimeve, milion Lek

Programet	Pagat dhe kontribute e sigurimeve shoqerore 600, 601	Mallra dhe sherbime 602	Subveconet 603	Te tjera transferte korrente 604, 605	Transferta per buxhetet familiare dhe individet 606	Shpenzime kapitale 230, 231	Total
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	163	105	0	0	0	426	694
Perfaqesite diplomatike dhe sherbimi konsullor	0	1 092	0	136	0	34	1 306
<b>Total</b>	<b>207</b>	<b>1 198</b>	<b>0</b>	<b>136</b>	<b>0</b>	<b>460</b>	<b>2 001</b>

## 5 Plani i Monitorimit të Ministrisë

Treguesit	Njësia	Qëllimi
<b>Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi</b>		
Numri i Protokolleve të Bashkëpunimit Ekonomik		8
Reforma e përgjithshme administrative e përfunduar		
<b>Perfaqësitë diplomatike dhe sherbimi konsullor</b>		
Përfaqësitë shqiptare ne Kosove, Mal te Zi te hapura		
Perfaqësitë shqiptare ne bote te kategorisë I te hapura		
Numri i personeli në përfaqësitë shqiptare		
Bruksel		15
Podgorice		3
Londër		5
Nju Jork		4
Godinat e ambasadave ne Prishtine, Berlin te blera		
Sistemit i rrjetëzuar i informacionit i krijuar		

## Aneks 1 Projekt-ligjet për tu paraqitur

Projekt-akte	Afati i paraqitjes në Këshillin e Ministrave
Projekt-ligji “Për një ndryshim në Ligjin nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të RSH”	Katërmujori II
Projekt-vendimi”Për miratimin e rregullores së shërbimit e jashtëm të RSH”	Katërmujori II
Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë të Europës Qëndore (CEFTA), të zgjeruar dhe të ndryshuar	Katërmujori I
Projekt-vendimi për miratimin në parim të Marrëveshjes për lëvizjen e lirë me Komunitetin Evropian”	Katër mujori II
Projektligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes për lëvizjen e lirë me Komunitetin Evropian”	Katërmujori III
Projektligji “Për ratifikimin Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës Italiane dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në luftën kundër kriminalitetit”	Katër mujori III
Projektligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes Strategjike ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shërbimit Policor Evropian”-	Katër mujori III
Kontrata financiare ndërmjet Bankës së Europiane të Investimeve për financimin e projektit ndërtimit terminalit të trageteve dhe shesheve përreth në portin e Durrësit.	
Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin e transportit	Gjashtë mujori II
Projektligji Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet RSH dhe IBRD, për projektin e transportit”	Gjashtëmujori II
Projektligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet RSH dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e Mbrojtjes së liqenit të Ohrit-kanalizimet, Pogradec II.	Gjashtëmujori II
Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin teknik dhe shkencor ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Argjentinës	Katër mujori III
Projektligji për zgjidhjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Republikës së Bullgarisë	Katërmujori II
Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë mbi bashkëpunimin në luftën kundër krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm dhe akteve të tjera kriminale.	Katër mujori III
Projektligji për aderimin e RSH në Konventën e OKB-së për mbrojtjen e të drejtave të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre	Katër mujori III
Projektligji për aderimin e RSH në Konventën për aksesin ndërkombëtare në drejtësi	Katër mujori III
Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin teknik ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Japonisë	Katër mujori I
Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për rindërtim dhe zhvillim për blerjen e reduktimeve të shkarkimeve të verifikuara (projekti shqiptar i rigjenrimit natyror të asistuar)	Katër mujori III
Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për zhvillim për financim në projektin e administrimit dhe menaxhimit të tokës	Katër mujori III
Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes kuadër të huasë ndërmjet RSH dhe Bankës de këshillit të Europës për Zhvillim për projektin Cilësi dhe barazim në arsim.	Katër mujori III
Projektligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Tregtisë së lirë me ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë”.	Katër mujori II
Projektligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave të RSH dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për krijimin e një qendre shërbimesh dhe rrjeti	Katër mujori III

telematik për univeristetet	
Projektligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet RSH-se OPEC per financimin e projektit zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale malore”.	
Projekt-ligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë “Për shmangien e Tatimit të Dyfishtë dhe Evazionit Fiskal në lidhje me Taksat mbi të Ardhurat dhe Kapitalin”	Katër mujori II
Projekt-Ligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes financiare “Për Programin e Veprimit Rajonal CARDS 2006”	Katër mujori II
Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare “Për Programin Vjetor rajonal CARDS 2006 të Asistencës Komunitare për autoritetet tatimore dhe doganore të Ballkanit Perendimor ndërmjet KM të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane”	Katër mujori I
Projekt vendimi për miratimin e Marrëveshjes Qeveritare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës federale të Gjermanisë Për financimin e Programit “Rezervati Biosferik ndërkufitar i Prespës-Mbështetja e Parkut Kombëtar të Prespës”	
Projekt-ligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe KFË, Frankfurt AM Main, Për financimin e Programit “Rezervati Biosferik ndërkufitar i Prespës-Mbështetja e Parkut Kombëtar të Prespës”	Katër mujori II
Projektvendimi për miratimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Qeverisë së Republikës së Polonisë	Katër mujori III
Projektvendimi për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Qeverisë së Republikës Qipros për bashkëpunimin në fushën e turizmit	Katër mujori III
Projektvendim “Për miratimin e marrëveshjes për bashkëpunimin doganor ndërmjet KM të republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë”	Katër mujori III
Projektligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, për projektin e transportit”	Gjashtëmujori I
Projektligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes së huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për rindërtim dhe zhvillim për projektin e transportit”	Gjashtëmujori I
Projektligj “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Memorandumin e Mirëkuptimit për kontrollin shtetëror portual, duke përfshirë edhe amendamentin e adoptuar në 9 maj 2002”	Gjashtëmujori I
Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen europiane për linjat ndërkombëtare hekurudhore kryesore”	Janar 2007
Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare mbi përgatitjen ndaj ndotjes nga nafta, reagimi dhe bashkëveprimi, 1990”	Shkurt 2007
Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën mbi lehtësirat e kalimit kufitar për udhëtimet turistike, bërë në Neë York, më 4 qershor 1954	Dhjetor 2007
Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen europiane për vendosjen e linjave dhe relacioneve të rëndësishme të transportit të kombinuar ndërkombëtar (AGTC) e 1 shkurt 1991	Dhjetor 2007
Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për taksimin e mjeteve rrugore që merren me transportin ndërkombëtar të udhëtarëve”	Dhjetor 2007
Projekt-ligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Doganore të Kontenierëve, 2 dhjetor 1972”	Dhjetor 2007

## Aneks 2 Rezultate që lidhën me Programin e Qeverisë

- Rritje e ndjeshme (70-75%) e shpërblimit të punonjësve të shërbimit me jashtë në përfaqsitë diplomatike jashtë vendit në përpjekje për sigurimin e kushteve me të mira të punës e jetesës së truput diplomatik shqiptar dhe rritjes së angazhimit të tij në realizimin e objektivave diplomatike.
- Rritje e përfaqësimit në fushën ekonomike dhe tregtare duke përfshirë në personelin e disa përfaqësive kryesore diplomatike përfaqësues të ministrive dhe institucioneve të tjera që do të punojnë për tërheqjen e investimeve të huaja, nxitjen e eksportit dhe ofrimin e një informacioni të shpejtë e të përditësuar mbi mundësitë që egzistojnë në Shqipëri.
- Hapje e një ose dy qendrave kulturore në vendet e tjera, veçanërisht atje ku ka një përqendrim të madh të bashkëtdhetarëve (Athinë ose/dhe Romë).
- Përmirësimi i shërbimeve, përmirësimi i prezencës konsullore, përmbushja e detyrave që dalin nga plani për zbatimin e MSA dhe përafrimin e legjislacionit. Konkretisht:
  - Kryerja e studimit të plote të rrjetit konsullor për të verifikuar nevojat dhe mangësitë, plotësimin me personelin e nevojshëm
  - Përmirësimi i taksave konsullore për shërbimet e ofruara
  - Përmirësimi i normave ligjore ekzistuese dhe hartimi i normave të reja të domosdoshme për të mundësuar përmirësimin e shërbimeve në përgjithësi
  - Rishikimi dhe zgjerimi i rrjetit të konsujve të nderit me përpjekje për vënie në eficiencë të plotë, me synim rritjen e prezencës në hapësira ku nuk jemi prezent
  - Përmirësimi i informimit publik ndërmjet përmirësimit të informacionit në Internet;
  - Fillimi i ngritjes së qendres së vizave në MPJ
  - Përmirësimi rrënjësor i punës në Sektorin e legalizimeve, me futjen e normave të reja, zgjerimin e bashkëpunimit me POSTE-n etj.
  - Futja e sistemeve të shërbimeve në distancë (me postë) në përfaqësi dhe të pagesave me sisteme bankare
  - Fillimi i programeve të trajnimit të nëpunësve konsullore (në bashkëpunim me Akademinë Diplomatike, IOM dhe MB)

## Aneks 3 Rezultate që lidhën me integrimin European

Gjatë vitit 2007, rezultatet e aktivitetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme që lidhen me Integrimin evropian do të jenë:

- Ratifikimi i MSA-së nga të paktën 10 vende anëtare të BE-së;
- Nënshkrimi dhe ratifikimi i Marrëveshjes së Lehtësimit të Regjimit të Vizave mes BE-së dhe Shqipërisë;
- Vënia në lëvizje dhe raportimi për zbatimin e katër angazhimeve të marra për minoritetet në kuadër të Planit të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit;
- Zhvillimi i të paktën 10 vizitave dypalëshe të Ministrit të Punëve të Jashtme në vendet anëtare të BE-së, me qëllim lobimin për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit;
- Zhvillimi i takimit të dialogut politik me trojkën e BE-së gjatë presidencës gjermane të BE-së dhe i task-forcave të rradhës me qëllim bërjen të ditura të politikave qeverisëse dhe trajtimin e çështjeve të tjera të ndjeshme që lidhen me zhvillimet politike në vend;
- Bërjen të ditur të qëndrimeve tona rreth zhvillimeve në Kosovë, rajon dhe në botë, tek partnerët tanë evropianë.
- Bashkimi i qëndrimeve me ato të politikës së jashtme dhe sigurisë me BE-së, atëherë kur shikohet e arsyeshme.

## Aneks 4 Rezultate që lidhën me anëtarisimin në NATO

Gjatë vitit 2007, rezultatet e aktivitetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme që lidhen me anëtarësimin në NATO do të jenë:

- Prezantimi dhe mbrojtja në strukturat vendim marrëse të Aleancës dhe pranë shteteve anëtare e progresit të bërë në të gjitha fushat, veçanërisht në ato fusha ku NATO tregon një ndjeshmëri të lartë.
- Angazhimi gjatë vitit 2007 i Autoriteteve më të larta të vendit në vizita në qendrat kryesor të vendimarrjes për çështjen e anëtarësimin, në mënyrë të veçantë në Ëashington dhe në Bruksel me synimin që të jemi të pranishëm në pothuajse tërësinë e kryeqyteteve të vendeve anëtare të NATO-s.
- Realizimin e një vizite të Këshillit të Ambasadorëve të NATO-s në Shqipëri me qëllim tërheqjen e vëmendjes në veprifikimin e progresit të bërë në vend për anëtarësim.
- Ndërgjegjësimi i vazhdueshëm, nëpërmjet mbledhjeve periodike të Komitetit Nderinstitucional për zbatimin e MAP-it, i strukturave të tjera të vendit në lidhje me përmbushjen në kohë të angazhimeve të marra në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit për Anëtarësi (MAP).
- Rritje e kapaciteteve administrative, rritje e kapaciteteve profesionale-diplomatike si dhe të prezencës dhe organizimit të aktiviteteve të nivelit të lartë si pjesë e lobingu-t të vazhdueshëm për anëtarësimin e suksesshëm në NATO në vitin 2009.
- Bërjen të mundur që brenda vitit 2007 Aleanca dhe vendet anëtare të kenë një opinion pozitiv të konsoliduar në lidhje me marrjen e ftesës për anëtarësim në vitin 2008.

## Aneks 5 Investimet publike

Emërtimi i projektit	Kosto (në milion lekë)
<b>Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi</b>	
Blerje pajisje zyre	2
Blerje kompjutera, printera, fotokopje	3
Rikonstrukcion ambjente Hotel Dajti	421
<b>Perfaqesite diplomatike</b>	
Blerje pajisje zyre dhe pajisje informatike per Perfaqesite Diplomatike	34





